# AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "XHANI"sh.p.k.

Ne zbatim te Ortakut te vetem Haxhi Xhani,banues ne lagjen Vehbi Dibra te qytetit te Peshkopise,krijohet Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "XHANI"sh.p.k. ,sot me date 26.04.1999,ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise.

## FORMIMI

1/1.-FORMIMI I SHOQERISE
Ortaku I vetem Haxhi Xhani krijon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me kreun 4 te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"
1/2-EMRI
Emri I shoqerise do te jete "XHANI" sh.p.k.
1/3.-QELLIMI DHE OBJEKTI
Qellimi dhe objekti I shoqerise do te jete:
Zbatimi I kategorive te specifikuara te punimeve si:
Kat 1-punime dheu,sistemime,tarracime terrenesh
Kat.2-a,c
Kat 3.-ndertime civile dhe ekonomike
Kat 4/a-ndertim rruge kat:5 ,4
Kat 8/b-ndertim ujesjellesa e kanalizime
Kat 10/a-rikonstruksione godina civile e ekonomike,veshje fasadash,import,eksport,artikuj te ndryshem industrial e ushqimoree materiale ndertimi , transport mallrash e udhetaresh,shitje mallrash te ndryshme me shumice e pakicesi dhe çdo operacion tjeter qe bashkohet me veprimtarine e mesiperme dhe konsiderohet e pershtatshme dhe me leverdi per rritjen dhe zhvillimin e metejshem te shoqerise,duke shtuar ose pakesuar objektin e aktivitetit te saj.
1/4-SELIA
Selia qendrore e shoqerise do te jete ne qytetin e Peshkopise,lagja Vehbi Dibra.Sipas vendimeve te miratuara ne perputhje me STATUTIN E SHOQERISE,ajo mund te hape dege,zyra,filiale ose perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte saj.
1/5 AFATI
Shoqeria do te kete nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike prej 10 vjetesh,qe shenon dhe kohen e mbarimit te aktivitetit.
1/6 KAPITALI
Kapitali I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "XHANI"sh.p.k. do te jete 100.000 leke dhe perbehet nga kontributi I ortakut te vetem.
1/7 LIBRI
Per te preçizuar dhe saktesuar veprimtarine e vet ekonomike si ato te marredhenieve te punes etj,shoqeria do te çele librin e vet qe do te quhet "libri ishoqerise".
1/8.VITI FINANCIAR
Viti financiar do te mbyllet me 31 dhjetor te vitit ne vazhdim.

## KAPITALI

*2/1.KONTRIBUTET E KAPITALIT*
Sasia e kapitalit do te derdhet sipas dispozites 1/6 te ketij akti e do te quhet "Kontributi I Kapitalit".
Kapitali e kontributi I tij fillimisht do te perdoret per shpenzime fillestare te shoqerise.
*2/2.-FINANCIMI*
Ne masen e duhur shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "XHANI"sh.p.k. ka te drejte te siguroje financim tregtar ose investues nga çdo banke e institucion financiar I vendit ose I hua,financim ky qe do te rregullohet me kontrate ose me marraveshje te posaçme.
*2/3.-CESHTJET FINANCIARE DHE LLOGARIA E SHOQERISE*
Shoqeria"XHANI"sh.p.k. do te mbaje llogari duke u mbeshtetur kryesisht tek LEKU shqiptar dhe tek valuta e forte.
Shoqeria do te kete si vit fiskal vitin kalendarik.

## STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

*3/1.-QENDRA*
Qendra e shoqerise "XHANI"sh.p.k. do te jete ne qytetin e Peshkopise te rrethit Diber.
*3/2-DREJTIMI*
Organi me I larte I shoqerise do te jete ORTAKU I VETEM
*3/3.-Shoqeria "XHANI"sh.p.k. do te administrohet nga ORTAKU I VETEM*

## DISPOZITA TE FUNDIT

Ky akt themelimi u hartua ne Peshkopi,sot me date 26.04.1999(nentedhjete e nente)ne kater kopje me permbajtje te njejte,ne gjuhen shqipe dhe nenshkruhet me vullnet~~in e lire~~ te ORTAKUT TE VETEM

ORTAKU I VETEM
HAXHI XHANI

# Statut
# I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Xhani" sh.p.k.

Ky status u redaktuas ne perputhje me legjislacionin ne fuqi te republikes se Shqiperise sot me date 26.040.1999 ne Peshkopi nga HAXHI XHANI, I biri I Ademit I vitlindjes 1947, lindur ne Muhurr, Diber dhe banues ne lagjen Vehbi Dibra te qytetit te Peshkopise, rrethi Diber I quajtur Ortak I vetem, I cili me vullnetin e tij te lire krijoi shoqerine me pergjegjesi te kufizuar Xhani sh.p.k.

## Kreu I

*Forma, emertimi, objekti, selia dhe kohezgjatja*

**Neni 1**
*Forma*
Haxhi Adem Xhani, I quajtur ortak I vetem ka krijuar shoqerine me pergjejgesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi te Republikes se Shqiperise si dhe dispozitat e ketij statuti.

**Neni II**
*Emertimi*
Emertimi I shoqerise do te jete Xhani sh.p.k.

**Neni III**
*Kohezgjatja*
Shoqeria do te kete nje kohezgjatje prej 10 vjetesh me perjashtim te rasteve kur kerkohet kohezgjatja ose prishja para kohe. Si dite fillestare merret dita e rregjistrimit te saj ne gjykaten e rrethit Tirane.

**Neni IV**
*Selia*
Selia e shoqerise do te jete ne qytetin e Peshkopise, rrethi Diber. Me vendim te ortakut te vetem mund te happen dege, zyra, filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise e jashte saj.

**Neni V**
*Objekti*
Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj zbatimin e punimeve per kategori te specifikuara si: kat I – punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh. Kat II/a,c, kat III – ndertime civile dhe ekonomike, kat IV/a – ndertim rruge, kat e IV dhe e V, kat e VIII/b – ndertim ujesjellesa dhe kanalizime, kat X/a – rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, eksport-import artikuj te ndryshem industriale dhe ushqimore dhe materiale ndertimi, transport mallrash e udhetaresh, shitje mallrash te ndryshme me shumice e pakice.

Shoqeria ka te drejte te shtoje ose te pakesoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te ortakut te vetem.

**Kreu II**

**Neni VI**
*Kapitali themeltar*
Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100 000 leke dhe perbehet nga kontributi I ortakut te vetem.

**Kreu III**

**Neni VII**
*Drejtimi*
Organi me I larte drejtues I shoqerise Xhani sh.p.k. do te jete ortaku I vetem.
**Neni VIII**
*Procesverbalet*
Vendimet e ortakut te vetem duhen hedhur ne nje procesverbal qe duhet te nenshkruhet prej tij
**Neni IX**
*Administrimi*
Shoqeria do te administrrohet nga nje administartor qe eshte ortaku I vetem.
**Neni X**
*Fuqite e organit administrativ*
Organi administrativ ka kompetenca te gjera qe perfshijne tere veprimtarine e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem te shoqerise dhe gjithçka tjeter te parashikuar me ligj.
organi administrativ ka kompetence:

- te marre pjese ne ankand,
- te marre pjese ne procedurat e falimentimit,
- te perpiloje kontrata dhe çdo akt tjeter juridik qe ka te beje me veprimtarine e shoqerise, te bleje, shkembeje, tjetersoje pasuri te luajtshme, tituj e aksionre, etj.,
- te hape llogari rrjedhese bankare,
- te marre obligacione dhe kambiale.
- Te marre pjese ne sipermarrje te tjera financiare dhe ne gjithçka qe do t'I interesoje shoqerise.
- te beje gjithçka tjeter qe e konsideron te dobishme e qe eshte ne perputhje me STATUTIN e AKTIN E THEMELIMIT si dhe me legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise per te realizuar qellimin dhe objektin e shoqerise.

**NENI 11**
*perfaqesimi:*
Shoqeria perfaqesohet perballe te treteve dhe organeve gjyqesore nga firma e lire e ORTAKUT TE VETEM, Haxhi Xhani.

**kreu IV**

**NENI 12**
*VITI FINANCIAR, LLOGARIA VJETORE:*

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.Perjashtimisht viti I pare financiar mund te filloje pas 1 Janarit1999 dhe te perfundoje me 31 dhjetor 1999.
Llogaria vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga
Administratori ose eventualisht edhe nga eksperti kontabel I autorizuar, miratohet prej vete ORAKUT TE VETEM.
Miratimi I dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati gjashtemujor nga data e mbylljes se vitit financiar.

**NENI 13**

*fitimi:*

Fitimi neto I bilancit shperndahet si vijon:
a.5% destinohet per te krijuar fondin rezerve te thjeshte derisa ky te arrije ne 1/5 te kapitalit themelor ose aq sa ortaku I vetem do t'a quaje te nevojshme rast pas rasti,ne rast se rezervat jane ulur ne 1/5 derisa te integrohet e tera.
b.Mbetja do te shperndahet konform vendimit te ORTAKUT TE VETEM.

**NENI 14**

*zgjatja e afatit:*

Zgjatja e afatit te shoqerise qe eshte e percaktuar ne kete statut mund te vendoset nga ORTAKU I VETEM.

**NENI 15**

*prishja:*

Shoqeria prishet me perfundimin e afatit te caktuar ne nenin 3 te ketij statuti,me perjashtim te rasteve kur behet zgjatja e afatit ose kur ka prishje te parakohshme per arsye te parashikuara ne ligj.

**NENI 16**

*vendi e koha e hartimit te statutit:*

Ky statut u hartua ne Peshkopi sot me date 26.04.1999(njemije e nenteqind e nentedhjete e nente) ne gjuhen shqipe e ne kater ekzemplare me permbajtje te njejte.

ORTAKU I VETEM
HAXHI XHANI